



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:134643  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05422715

Ac.nr.554/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Bujar Muzaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, të cilën me autorizim e përfaqëson D.C, kundër të paditurit B.B, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati F.Sh, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.703/19, të datës 09.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit B.B, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.703/19, të datës 09.10.2019, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.703/19, të datës 09.10.2019, ka vendosur më sa vijon:

I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit dhe DETYROHET i padituri B.B që paditëses t'i paguaj shumën prej 4,567.50 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 02.05.2012 me kamat pre 8%, nga data 09.10.2019 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

II.REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses BKS ushtruar ndaj të paditurit B.I në shumë prej 1,957.50 Euro.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që

gjkata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën dhe ta prish aktgjykimin ankimor dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve, me datën 02.12.2013, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit, për shkak të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 02.05.2012, me arsye sikurse në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka filluar procedurën dhe pas marrjes së përgjigjes në padi, vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka marrë aktgjykimin e ankimuar me përmbajtje sikurse në dispozitivin e tij. Në arsyetim ka cekur se në bazë të aktgjykimit penal, ekspertizës së komunikacionit, procesverbaleve në çështjen kontestimore të udhëhequr me numër 107/12 dhe urdhërtransferi dhe raporti i transferit ka vërtetuar se shkaktar i aksidentit me lëshime primare është i padituri B.I, ndërsa e dëmtuara ka pasur lëshime sekondare, pra në rastin konkret kemi përgjegjësi të ndarë në shaktimin e aksidentin. Dëmin e shkaktuar nga aksidenti të dëmtuarës I.L BKS-ja ia ka kompensuar në shumë prej 6.525.00 Euro e vërtetuar përmes Urdhërtransferit të BKS-ës dhe raportit të transferimit të parave, dëm ky i cili është caktuar në Pajtimin Gjyqësor që ka arritur tani paditësja BKS me të dëmtuarën I.L në procedurën kontestimore të datës 04.06.2013. Pas vërtetimit të kompensimit të dëmit nga paditësja për të dëmtuarën rrjedh e drejta e paditëses që të kërkojë rimbursimin e dëmit nga i padituri B.I sipas nenit 18 par.4 të LSDA-së. Gjykata ka vlerësuar se kemi të bëjmë me ndarje të përgjegjësisë së shkaktimit të dëmit ndërmjet të paditurit dhe të dëmtuarës pasi të dyja palët, tani i padituri dhe e dëmtuara kanë marrë pjesë së bashku në shkaktimin e dëmit paditësja BKS ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e dëmit nga i padituri në bazë të përgjegjësisë dhe kontributit të tij në shaktimin e aksidentit, saktësisht në shumën prej 4,567.5 Euro sepse konsiderohet se edhe e dëmtuara ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit. Gjykata ka çmuar se kërkesëpadija e paditëses përkitazi me lartësinë e pretenduar pjesërisht ka themelësinë në prova materiale, përkatësisht në raportin policor, ekspertizën e komunikacionit, aktgjykimin penal, urdhërtransferi, andaj për këto arsye i padituri është pjesërisht përgjegjës për të rimbursuar këtë dëm që paditësja ka qenë e detyruar fillimisht ta paguaj ndaj personave që ka pësuar dëme nga aksidenti i shkaktuar nga i padituri dhe rrejdhimisht për pasojë të kësaj, i padituri ka detyrimin që këtë shumë t'ia rimbursion paditëses, ndërsa refuzimi i kërkesëpadiës së paditëses në shumën prej 1,957.50 Euro është bërë duke u bazuar në ndarjen e përgjegjësisë, ku e dëmtuara I.L ka qenë e pakujdesshme gjatë kalimit të rrugës sepse nuk është kujdesur paraprakisht se nuk ka lëvizje të automjeteve në rrugë si dhe nuk ka përdorur vendkalimin për këmbësor. Gjykata vlerëson se paditësja nuk ka pasur detyrim t'ia paguaj shumën e refuzuar si në këtë Aktgjykim të dëmtuarës F.G, duke marrë parasysh faktin se e njëjta ka kontribuar në lartësinë e dëmit. Me rastin e vendosjes gjykata është bazuar në nenet 22; 24; 26; 31 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 136; 169; 173; 174; 176; 182; 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligji mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nenet 9; 10; 11; 12 dhe 14; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e as në shkeljet e pretenduara me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara dhe atë nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga F.S është vërtetuar se deri te aksidentit ka ardhur si pasojë e lëshimeve primare të paditurit dhe lëshimeve sekondare të dëmtuarës, e cila motoçikletë ka qenë i pa regjistruar dhe i pa siguruar, ndërsa me aktgjykimin penal të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.1877/12 e datës 18/02/2014, vërtetohet se i padituri është shpallur fajtor për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit dhe është gjykuar sipas ligjit, ndërsa paditësja me të dëmtuarën kanë arritur pajtim gjyqësor në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.107/12 e datës 04/06/2013 në shume prej 6,525.00 euro, ku në bazë të urdhër pagesës së datës 18/06/2013, vërtetohet shuma e paguar në lartësi prej 6,525.00 euro.

Gjykata e Apelit, e ka pranuar në tërësi përfundimin e shkallës së parë për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadsisë, ngase edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje juridike kontestuese. Sipas nenit 18 par.1 i përcakton se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”,* par.4 i këtij neni përcakton se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*. Meqenëse, i padituri nuk ka pasur mbulesë të sigurimit, atëherë përgjegjësia e kompensimit ka rënë mbi paditësen, andaj e njëjta konform dispozitave ligjore të sipër theksuara ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin për dëmin e paguar ndaj personave të tretë si pasojë e shkaktimit të atij dëmi nga ana e të paditurit dhe atë sipas përgjegjësi se ndare 70 % për të paditurën ndërsa 30 % për të dëmtuarën. Në rastin konkret i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik-civil i të paditurit, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:134643  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05422715

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
Ac.nr.554/20, me datë 06.03.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku